



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 32, Datë 30.04.2009

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“SiCRED” SH.A**

Në zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 55, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e ndryshimeve në statutin e Shoqërisë së Sigurimit “SiCRED” SH.A, me përmbajtje si më poshtë:**
 - a) Neni 7, paragrafi 7/1 bëhet “Zmadhimi i kapitalit themeltar mund të kryhet vetëm me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të aksionerëve, në bazë të raportit të Këshillit Mbikëqyrës ose të Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë. Raporti duhet të përmbajë treguesit e treguar nga ligji”*
 - b) Neni 13, paragrafi 4 bëhet “Pronësia e një aksioneri përmban automatikisht të drejtën e pjesëmarrjes së Statutin e Shoqërisë dhe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme”.*
 - c) Neni 16, paragrafi 2 bëhet “Emërimi i Anëtarëve nga vetë Këshillit duhet të miratohet nga Mbledhja më e afërt e aksionerëve”.*
 - d) Neni 18, paragrafi 2 bëhet “Këshilli Mbikëqyrës mblidhet si rregull një herë në tre muaj dhe sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë. Në fund të çdo tre mujori me kërkesën e Këshillit ose të Drejtorit të Përgjithshëm mund të thirret në raport Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë”.*
 - e) Neni 18, paragrafi 4 bëhet “Njoftimi për mbledhje dërgohet në vëmendje të pjesëmarrësve 5 ditë përpara me letër, ose formë tjetër të shkruajtur komunikimi”.*
 - f) Neni 25, bëhet “Drejtori i Përgjithshëm i ushtron kompetencat e tij drejtëpërdrejtë ose nëprmtjet personave të tjerë të autoirizuar”.*
 - g) Paragrafi 3, i nenit 14 shuqëzohet.*

h) Pika 2, e nenit 21 shfuqëzohet.

i) Gërma c,) e nenit 21 shfuqëzohet.

j) Paragrafi 2, i nenit 23 Shfuqëzohet.

2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**